Programi i studimit të ciklit të tretë **"Doktoratë" në "Shkenca Ekonomike dhe Juridike"** synon t'u ofrojë kandidatëve për doktoratë një mjedis kërkimor të standardeve të larta akademike dhe shkencore. Kandidatët do të përqendrohen në zhvillimin e aftësive për identifikimin, formulimin dhe trajtimin e çështjeve dhe pyetjeve të reja e origjinale kërkimore, duke përdorur metoda dhe instrumente bashkëkohore të kërkimit sasior dhe cilësor.
Programi synon formimin e kërkuesve dhe profesionistëve me kompetenca të avancuara shkencore, si dhe kontributin në zgjerimin, zhvillimin dhe përparimin e njohurive në fushat e ekonomisë, biznesit, qeverisjes dhe drejtësisë, në funksion të zhvillimit të mëtejshëm të sektorit publik dhe privat.Realizimi i këtyre objektivave mbështetet në angazhimin e vazhdueshëm të kandidatëve në veprimtari kërkimore gjatë gjithë kohëzgjatjes së programit, në mentorimin dhe udhëheqjen shkencore nga stafi akademik i njësive bazë, në bashkëpunimin ndërmjet fakultetit dhe kandidatëve për doktoratë, si dhe në një qasje të konsoliduar multidisiplinare.
Kjo qasje synon t'u ofrojë kandidatëve thellësinë e nevojshme teorike dhe metodologjike për zhvillimin e kërkimit shkencor dhe hartimin e disertacionit, në përputhje me standardet akademike dhe shkencore të ciklit të tretë të studimeve.

Fushat e studimit dhe nënfushat përkatëse janë si më poshtë:

1. Shkenca Ekonomike
• Kontabilitet
• Financë
• Menaxhim, sipërmarrje dhe inovacion
• Marketing dhe sjellje konsumatore

2. Shkenca Juridike
• Studime kushtetuese
• E drejtë ndërkombëtare publike
• E drejtë evropiane
• E drejta tregtare në Bashkimin Evropian
• E drejtë penale dhe procedurë penale
• Kriminologji & penologji
• Krimi ekonomiko-financiar

Objektivat e programit të studimit:

- Të zhvillojë aftësitë analitike dhe kritike të kandidatëve për doktoratë përmes trajtimit të perspektivave të shumëfishta disiplinore, duke u mundësuar atyre të analizojnë, krahasojnë dhe sintetizojnë në mënyrë kritike teoritë, konceptet dhe çështjet komplekse në fushat e shkencave ekonomike dhe juridike.

- Të aftësojë kandidatët për integrimin e njohurive teorike dhe metodologjive bashkëkohore të kërkimit shkencor, në funksion të trajtimit të çështjeve komplekse në fushat e ekonomisë, financave, kontabilitetit, biznesit, menaxhimit, qeverisjes dhe drejtësisë.
- Të zhvillojë kompetencat kërkimore të kandidatëve për doktoratë, duke i aftësuar për konceptimin, projektimin dhe realizimin e kërkimeve shkencore origjinale, rigoroze dhe me vlerë të shtuar, që adresojnë sfida dhe problematika konkrete të sektorit publik dhe privat.
- Të forcojë aftësitë komunikuese dhe prezantuese të kandidatëve, duke i aftësuar për të prezantuar dhe diskutuar rezultatet e kërkimit të tyre në konferenca, seminare dhe forume akademike, si dhe për të publikuar punimet shkencore në revista dhe botime kombëtare e ndërkombëtare.
- Të nxisë zhvillimin e mendimit të pavarur shkencor dhe të inovacionit, duke promovuar kërkimin ndërdisiplinor, bashkëpunimin akademik dhe kontributin origjinal në avancimin e njohurive shkencore dhe në adresimin e sfidave të zhvillimit ekonomik, institucional dhe juridik.

Elementet e planit vjetor të programit të studimit të doktoratës, në funksion të projektit kërkimor shkencor dhe të zhvillimit të financuar të njësisë bazë

Plani vjetor i programit të studimit të doktoratës përcakton veprimtaritë akademike dhe kërkimore-shkencore që do të realizohen nga kandidatët për doktoratë, në përputhje me projektin e tyre kërkimor, objektivat e programit dhe projektet kërkimore-shkencore e të zhvillimit të financuara të njësisë bazë.

a) Koha e realizimit të veprimtarive të kombinuara, kur programet e studimit të doktoratës zhvillohen me kohë të plotë, sipas kohëzgjatjes normale të studimit nga 3 deri në 5 vite, bëhet sipas planit doktoral të miratuar nga njësia bazë përgjegjëse.

b) Koha e realizimit të veprimtarive të kombinuara, kur programet e studimit të doktoratës zhvillohen me kohë të zgjatur, sipas kohëzgjatjes normale të studimit 5 vite, bëhet sipas planit doktoral të miratuar nga njësia bazë.

Nr.	**Aktivitetet**	**Programi 3-vjeçar**	**Programi 5-vjeçar**
1	Seminare për teoritë bashkëkohore, debatet aktuale të fushës përkatëse të studimit	I	I
2	Takimi me doktorantët në lidhje me pyetjen/et kërkimore/hipotezat e studimit	I	I
3	Takimi me doktorantët në lidhje me Literaturën	I	II

4	Takimi me doktorantët në lidhje me problematikat, modelin analitik, apo qasjet krahasuese që do të përdoren	II	III
5	Takimi me doktorantët në lidhje me strukturën e disertacionit	II	III
6	Takimi me doktorantët në lidhje me instrumentet kërkimore, teknikat e vrojtimit dhe eksplorimit, si dhe procedurat e mbledhjes, përpunimit dhe sistemimit të të dhënave kërkimore.	II	IV
7	Takimi me doktorantët në lidhje me instrumentet dhe teknikat e kërkimit shkencor, metodat e vrojtimit dhe eksplorimit, mbledhjen,klasifikimin, kualifikimin dhe përpunimin e të dhënave kërkimore.	II	IV
8	Takimi me doktorantët në lidhje me analizimin e të dhënave; testimin e modeleve të përdorur; gjetjet e studimit	III	V
9	Takimi me doktorantët në lidhje me formulimin e përfundimeve kërkimore, dhe hartimin e rekomandimeve, si dhe evidentimin e kontributit shkencor të studimit.	III	V
10	Prezantimi në departament	III	V
11	Trajnime, Workshop-e	II, III	III, IV, V
12	Konferenca kombëtare, ndërkombetare, publikime në revista	II, III	III, IV, V
13	Angazhim ne mësimdhënie	I, II, III	III, IV, V
14	Mbrojtja finale	III	V